



RAPORTI I - VII - | PËR MUJIN GUSHT 2010

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Raporti i Monitorimit mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë Kundër Korrupsionit

*“... korrupsioni është një sëmundje e  
tmerrshme që shkatërron çdo vend nga  
brenda...”*

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	5
Hyrje.....	6
Qeveria e Kosovës.....	7
Sistemi Gjyqësor.....	7
Policia e Kosovës.....	10
Doganat e Kosovës.....	11
Raportimet e Gazetave.....	12
Raportet nga Shoqëria Civile.....	12
Lëvizja FOL.....	12
Falënderime.....	13
Rreth Lëvizjes “FOL”.....	13

## LISTA E AKRONIMEVE

**AAK** – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

**AKK** – Agjencia Kundër Korrupsionit

**BQK** – Banka Qendrore e Kosovës

**BE** – Bashkimi Evropian

**DHKEK** – Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

**EULEX** – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

**ISC** – Institute for Sustainable Communitities (Instituti për Komunitete të Qëndrueshme)

**KDI** – Kosovo Democratic Institute (Instituti Demokratik i Kosovës)

**LDD** – Lidhja Demokratike e Dardanisë

**MPB** – Ministria e Punëve të Brendshme

**PDK** – Partia Demokratike e Kosovës

**PK** – Policia e Kosovës

**SSP** – Sektori i Standardeve Profesionale

## PËRMBLEDHJE

Nga 34 vendime të Qeverisë së Kosovës për muajin gusht as edhe një vendim i vetëm nuk ka qenë në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky muaj shënjon njëkohësisht edhe muajin më të dobët të aktiviteteve qeveritare në luftë kundër korrupsionit;

Prokuroria Speciale e Kosovës është duke hetuar 73 raste të korrupsionit, 38 prej të cilave janë të profilit të lartë. Ndërkaq, në Veri të Kosovës janë duke u hetuar 25 raste, nga të cilat 6 konsiderohen me prioritet: për krim të organizuar dhe korrupsion;

Gjyqësori i Kosovës për muajin korrik ka zgjidhur vetëm 3 lëndë që kanë të bëjnë me afera korruptive, ndërkaq 270 prej tyre kanë mbetur të pazgjidhura, duke demonstruar kështu një nivel mjaft të dobët të funksionimit të tij;

Në Policinë e Kosovës gjatë dy muajve (korrik dhe gusht) janë paraqitur 67 raste të shpërdorimit të detyrës zyrtare, 16 raste përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, 11 raste marrje të rryshfetit dhe vetëm 1 rast dhënie të rryshfetit;

Nga 35 artikuj të publikuar nga gazetatat e përditshme (Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe Express), vetëm 21 janë realizuar si tema, 9 lajme dhe 5 intervista. Derisa Koha Ditore dhe Zëri janë fokusuar më shumë në kritikën ndaj Ekzekutivit të vendit dhe ndërmarrjeve publike, kritikën e Kosova Sot janë përqendruar më shumë në Gjyqësorin e Kosovës. Ndërkaq, fokusi i gazetës Express kryesisht ka qenë tek dështimet e ministrive të LDK-së dhe të Komunës së Prishtinës;

Në kuadër të Doganave të Kosovës janë paraqitur 2 raste: 1 rast për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe 1 rast për dëmtim të pronës së Doganave të Kosovës;

Lëvizja FOL ka publikuar Raportin e saj “Trekëndëshi i Bermudës”, në të cilin është pasqyruar mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional (Prokurori, AKK dhe EULEX) në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

## HYRJE

Korrupsioni, i vlerësuar si sfida kryesore për shoqërinë e Kosovës përgjatë 11 viteve të transicionit, vazhdon të mbetet shqetësim i përbashkët i të gjithëve: politikanëve, shoqërisë civile e mediave. Ndërkombëtarët adresojnë këtë çështje në raportet/vlerësimet e tyre të përvitshme dhe qëndrimet deklarative. Bashkimi Evropian me Raportet e Progresit, e Departamenti Amerikan i Shtetit me raportet periodike për çështje të veçanta, mbesin vërejtjet publike që Kosova i merr pothuajse rregullisht viteve të fundit. Ndërsa raportet e organizatave jo qeveritare ndërkombëtare për Kosovën, kanë qenë të vazhdueshme dhe shpesh herë më të ashpra në adresimin e korrupsionit.

Vendasit mbeten të ndarë në qasjen për korrupsionin dhe luftën kundër tij. Përderisa pushtetarët zotohen për 'zero tolerancë korrupsionit dhe krimit të organizuar', opozita adreson të kundërtën, duke e cilësuar 'qeverinë – koka e korrupsionit'. Qëndrimet e tyre për çështjen në fjalë ndryshojnë me ndërrimin e pushtetit, e bashkë me të edhe rolet e tyre. Përgjatë qeverisjes nën administrimin e UNMIK-ut, dhe pas shpalljes së pavarësisë, publiku kosovar në rolin e spektatorit ka mundur të përcjell rokadën e pushtetit dhe retorikën pothuajse boshe për luftën kundër korrupsionit. Çështja e statusit, e më pas bërja e shtetit, janë shndërruar Atutë kryesore pas të cilave politikanët kosovarë janë fshehur vazhdimisht.

Dy vite pas shpalljes së pavarësisë, raportimet investiguese të medieve për korrupsionin, instalimi i Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX, dhe forcimi i thirrjeve të shoqërisë civile, kanë prioritetizuar 'luftën kundër korrupsionit'. Edhe pse arrestimi i 'peshqve të mëdhenj' është zëvendësuar me të vegjlit, madje në nivel komunal, pritjet që ndërkombëtarët dhe Kryeministri Thaçi kanë krijuar

për qytetarët, do ta shoqëroj edhe për një kohë politikën ditore në Kosovë.

Lëvizja FOL vazhdon monitorimin e aktiviteteve të institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit. Në periodikun e shtatë me radhë, për muajin gusht, shihet qartazi mungesa e aktiviteteve qeveritare në luftë kundër korrupsionit. Nga statistikat e Gjyqësorit shihet se kjo shtyllë nuk është duke treguar nivel të lartë të përgjegjësisë dhe profesionalizmit në zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë më afera korruptive. Ndërkaq, Policia dhe Doganat e Kosovës janë duke dëshmuar një seriozitet më të madh në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

## QEVERIA E KOSOVËS

Qeveria e Kosovës gjatë gjithë muajit gusht ka qenë e përqendruar në projekt-rezolutën serbe për Kosovën dhe aspak në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Debati mbi korrupsionin është duke u zbehur si rezultat i çështjeve makropolitike: sovraniteti, integriteti territorial, veriu i Kosovës dhe anëtarësimi në strukturat ndërkombëtare. Në këtë kuptim, të gjitha përpjekjet dhe angazhimet e Qeverisë, përgjatë gjithë muajit gusht, kanë qenë të orientuara në kundërshtimin e projekt-Rezolutës serbe për Kosovën. Ndonëse ka miratuar 34 vendime, as edhe një vendim i vetëm nuk ka qenë kundrejt aferave korruptive, duke shënjuar njëkohësisht edhe muajin më të dobët të aktiviteteve qeveritare në kuadër të sferës anti-korrupsion. Edhe pse kryeministri Thaçi e ka shpallur veten bartës të luftës kundër aferave korruptive, shumë pak është duke bërë në përmbushjen e këtij zotimi. Në njërën anë deklaroi se do të jetë udhëheqës i kësaj lufte dhe në anën tjetër thekson që luftimi i korrupsionit është përgjegjësi e sistemit gjyqësor. Nëse lufta ndaj korrupsionit është përgjegjësi e Drejtësisë, atëherë si mundet që Kryeministri ta shpallë veten bartës dhe prijës të kësaj lufte? Andaj, Qeveria e Kosovës duhet ta merr seriozisht luftimin e korrupsionit dhe të mos e reduktojë këtë luftë vetëm në lojë fjalësh: duke mos ndërmarrë asnjë veprim konkret, asnjë qasje serioze dhe asnjë angazhim për shkarkimin e zyrtarëve të dyshuar për afere korruptive. Lufta ndaj korrupsionit duhet të jetë e palëkundshme, ngase kjo dukuri rrezikon qeverisjen e mirë, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik<sup>1</sup> dhe dëmton proceset demokratike.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Rreth efekteve negative të Korrupsionit shih <http://www.oecd.org>

<sup>2</sup> James B. JACOBS: Korrupsioni dhe Demokracia, Kappa Phi Journal, Volumi 84, 2004, fq. 21

Përveç mungesës së aktiviteteve qeveritare për muajin gusht, edhe partitë opozitare nuk kanë qenë aq të zëshme për praktikën abuzive dhe aferat korruptive të Qeverisë së Kosovës. Ajo që do të mund të specifikohet me këtë rast është akuzat e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e cila e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës, gjegjësisht Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), për keqpërdorim të miliona eurove në rastin e dhënies së tenderit për targat apo automjetet. Ndërkaq, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX, kishte paralajmëruar se do të ketë arrestime në Mitrovicën e Veriut. Zëvendëshefi i këtij Misioni, Roy Reeve ka pohuar që do të ketë arrestime të disa personave nga veriu i Kosovës dhe se ekipet e këtij Misioni po punojnë në hetim dhe që së shpejti mund të priten rezultate. Ai ka pohuar ndashtu se EULEX-i kishte trashëguar shumë raste nga UNMIK-u dhe së shpejti do të analizohen ato dhe do të dihen rezultatet konkrete.<sup>3</sup> Sa i përket këtyre zotimeve, pritet në muajt në vazhdim nëse do të ndërmerren këto aktivitete dhe arrestime të paralajmëruara.

## SISTEMI GJYQËSOR


Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme, të cilitdo sistem politik, është edhe pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, atëherë apriori siguron dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo të pozitës zyrtare. Në këtë kontekst, njëra nga arsytet pse korrupsioni dhe krimi i organizuar është shtrirë gjithandej institucioneve, është edhe zhytja e vet sistemit gjyqësor në korrupsion dhe rënia e tij në grackën e presioneve dhe interferencave politike. Një konstatim të tillë e konfirmon edhe Raporti i fundit i EULEX-it, i cili thekson se sistemi i drejtësisë në Kosovës ende tregon shenja të dobësisë. Më tutje thuhet se interferencat në nivele të ndryshme dhe

<sup>3</sup> Një deklaram I tillë është dhënë për radion "Kontakt Plus", shkruar nga gazeta Express, dt. 21 gusht 2010, fq. 3

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

në forma të llojlojta janë evidentuar.<sup>4</sup> Gjyqësori i Kosovës vazhdon të jetë institucioni që qytetarët janë më së paku të kënaqur. Edhe Raporti i Paralajmërimit të Hershëm kishte regjistruar një rënie prej 10% që shënon nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë.<sup>5</sup> Prandaj, meqë demokracitë assesi nuk mund të funksionojnë pa sistemin gjyqësor, ngase garanton dhe kontrollon pushtetet tjera, atëherë edhe Kosova duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe seriozë për reformimin e thellë të saj. Në muajin gusht është raportuar se Prokuroria Speciale e Kosovës është duke u marrë me 193 raste, prej të cilave 73 janë raste të korrupsionit. Nga ky numër, 38 raste konsiderohen si raste të profilit të lartë. Edhe në Veri të Kosovës janë duke u hetuar 25 raste, nga të cilat 6 konsiderohen si raste me prioritet: për krim të organizuar, korrupsion, kontrabandë, vrasje dhe tentim vrasje (Kosova Sot).

Prokuroria Speciale dhe veçanërisht Task-Forca Anti-Korrupsionit duhet që të angazhohen mirëfilli në luftimin e korrupsionit. Që nga themelimi i kësaj Task-Force vetëm një veprim serioz e kemi parë të ndërmarrë me rastin e arrestimit të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës. Prandaj, këto raste që janë duke u hetuar, konsiderojmë që duhet të procedojnë më shpejtë dhe me veprimet e tyre të na bindin se janë duke e arsyetuar misionin dhe arsyen e ekzistencës së tyre.




Tab (1): Statistikat e Anti-Korrupsionit në Prokurorinë Speciale të Kosovës

<sup>4</sup> Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 9

<sup>5</sup> Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 2

## MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Sipas statistikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për muajin korrik shihet se vetëm 3 lëndë janë zgjidhur par rastet e korrupsionit, ndërkaq 270 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura. Prandaj, kjo tregon një nivel tejet të dobët të gjyqësorit të Kosovës, duke mos zgjidhur lëndët që kanë të bëjnë me aferat korruptive. Sic shihet nga tabela nr. 2, kategoria e shpërdorimit të pozitës zyrtare dhe ajo i dhënies së rryshfetit janë dy kategori më të theksuara në kuadër të sistemit gjyqësorë të Kosovës. Sipas këtyre të dhënave, këto dy kategori përbëjnë shumicën dërrmuese të lëndëve të aferave korruptive që kanë mbetur për t'u zgjidhur: 246 lëndë.



Tab (2): Statistikat e Anti-Korrupsionit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës – Muaji Korrik 2010




# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

## POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës perceptohet nga qytetarët e Kosovës si institucioni më i besueshëm dhe më pak i korruptuar. Rreth 76% e qytetarëve (përkundëjt 72% në shtator 2009) e të intervistuarve kanë qenë të kënaqur me punën e Policisë së Kosovës dhe vetëm një përqindje e vogël mendojnë se korrupsioni është i pranishëm në Policinë e Shtetit. Edhe Raporti i fundit i EULEX-it pati treguar një shkallë progresioni të Policisë së Kosovës në relacion me kundërvënien ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar<sup>6</sup>. Gjatë dy muajve (korrik dhe gusht) Policia e Kosovës ka realizuar një sërë veprimesh në luftën e saj kundër abuzimit me autoritetin publik.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezultojnë që gjatë muajit korrik Policia e Kosovës ka ndërmarrë 33 raste nën hetime, 27 të dërguara në Prokurori me kryerës të njohur, 7 në Prokurori N/N, 10 me Raport në Prokurori dhe 5 të arrestuar. Ndërkaq, statistikave të muajit gusht tregojnë se 28 raste kanë qenë nën hetime, 19 të dërguara në Prokurori me kryerës të njohur, 15 me Raport në Prokurori dhe asnjë arrestim i vetëm. Bazuar në këto statistika, numri i rasteve që ndërliken me marrje të rryshfetit, dhënie të rryshfetit dhe shpërdorimit të autoritetit zyrtar ka qenë i theksuar më shumë gjatë muajit korrik sesa gjatë muajit gusht.




Tab (3): Periudha Korrik-Gusht – Statistikat e Anti-Korrupsionit në Policinë e Kosovës

<sup>6</sup> Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 13-23


# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Ndërkaq sa i përket kategorive të aferave korruptive, për muajin korrik statistikat tregojnë se kategoria e shpërdorimit të detyrës zyrtare ka shënuar numrin më të madh të rasteve të paraqitura me gjithsej 28 raste; 4 raste përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare; 1 rast marrje të ryshfetit dhe 1 tjetër dhënie të ryshfetit.



Tab (4): Statistikat e Anti-Korrupsionit në Policinë e Kosovës – Muaji Korrik 2010

Ndërsa statistikat e muajit gusht demonstrojnë se në kuadër të kategorisë shpërdorim të detyrës zyrtare janë paraqitur 39 raste, 14 përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës dhe 10 raste marrje të ryshfetit dhe asnjë rast të dhënies së ryshfetit. Nëse marrim në analizë krahasues këta dy muaj, shihet se muaji gusht ka qenë më i “pasur” sa i përket rasteve të aferave korruptive me gjithsej 63 raste të aferave korruptive kundruall muajit maj me gjithsej 32 raste.




Tab (5): Statistikat e Anti-Korrupsionit në Policinë e Kosovës – Muaji Gusht 2010

## DOGANAT

Statistikat e Anti-korrupsionit të Doganave të Kosovës tregojnë se gjatë muajit gusht nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore. Ndërkaq, në Sektorin e Standardeve Profesionale është iniciuar procedura e hetimit për keqpërdorim të detyrës zyrtare, për humbje të pronës së Doganës dhe një person tjetër për mos-ardhje në punë. Për dallim nga muajt paraprakë, muaji gusht dëshmon që niveli i korrupsionit është duke u luftuar seriozisht nga ana e autoriteteve të Doganës së Kosovës dhe shpresojmë që këto masa parandaluese do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

## Statistikat e Korrupsionit në Doganat e Kosovës - Gusht




Tab (6): Muaji Gusht – Statistikat e Anti-Korrupsionit në Doganat e Kosovës

### RAPORTIMET E GAZETAVE

Të gjitha gazetat e monitoruara nga stafi i Lëvizjes FOL, të cilat vizatojnë dhe pasqyrojnë zhvillimet e gjithmbarshme në Kosovë, shpërfaqin një nivel të lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ndonëse shumica e raportimeve të mediave janë të përqendruara në lajme, në mesin e tyre ekzistojnë gazeta që realizojnë edhe tema të ndryshme, të cilat më pastaj janë ngritur në nivel të debatit. Nga 35 artikuj të publikuar nga gazetat e përditshme (Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe Expressi), 21 janë realizuar si tema, 9 lajme dhe vetëm 5 intervista. Andaj, nevoja dhe domosdoshmëria për realizimin e temave dhe intervista, në mënyrë që të zvogëlohet është tepër e madhe dhe do t'i kontribuonte jashtëzakonisht shumë luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Koha Ditore dhe Zëri më shumë kanë qenë të fokusuar në Qeverinë dhe Ndërmarrjeve Publike të Kosovës. Ndërkaq, kritikën e gazetës Kosova Sot ka qenë më shumë të fokusuar në Gjyqësorin e vendit dhe më pak për Qeverinë dhe Ndërmarrjet Publike, ndërkaq Express-i më shumë në nivel lokal: 27 lajme dhe 21 tema. Konstatim të ngjashëm ka nxjerrë pothuajse edhe Raporti i

Reporterëve pa kufij, sipas të cilit Koha Ditore dhe Zëri më shumë kanë ruajtur pavarësinë e tyre gazetareske.<sup>7</sup>



Tab (7): Statistikat e Raportimeve Anti-Korrupsion të Gazetave - Muaji Gusht 2010

### RAPORTET NGA SHOQËRIA CIVILE

Edhe shoqëria civile në Kosovë, e cila pranohet gjerësisht se është esenciale për proceset demokratizuese në vendin tonë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në luftë kundër korrupsionit dhe praktikave tjera korruptive. Qëllimi i aktiviteteve të shoqërisë civile, përkatësisht e organizatave jo-qeveritare, ka qenë denoncimi i praktikave korruptive dhe deformuese të keq-qeverisjes. Në këtë kontekst, gjatë muajit qershor janë shënuar dy aktivitete të ndryshme nga dy organizata të ndryshme.

**LËVIZJA FOL** - Gjatë këtij muaji ka publikuar Raportin e saj "Trekëndëshi i Bermudës". Ky Raport ka vënë në pah dobësitë e hallkës së bashkëpunimit

<sup>7</sup> Më gjerësisht shih Olivier BASILE: Kosovë- nuk është ende vonë për liri të shprehjes, Reporterët pa Kufij, 6 korrik 2010

# MONITORUESI I KORRUPSIONIT

ndërmjet EULEX-it, Prokurorisë dhe Agjencionit Anti-Korrupsion të Kosovës. Sipas këtij Raporti gjendja aktuale e koordinimit ndër-institucional është mjaft shqetësuese dhe rekomandohet që të gjitha institucionet që janë përgjegjëse për luftimin e korrupsionit duhet t'i sendërtuar aktivitetet e tyre në mënyrë që të reduktohet niveli i lartë i korrupsionit në institucionet publike të Kosovës.

## FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga ISC – Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë webfaqe: [www.monikorr.org](http://www.monikorr.org)

## RRETH LËVIZJES “FOL”

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën

qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

## KONTAKTO:

Andrea Gropa 29, 100000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Mob: +377 (0) 44 131 542

Ueb: [levizjafol.org](http://levizjafol.org)

E-mail: [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org)